Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0087

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE "Pattern" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje dhe pjesë elektronike të IT-së –Ritender 2 Pjesa2" me numër të prokurimit; 214-24-13444-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës, më 18/**04/2025**, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet,si e pabazuar ankesa e OE"Pattern" SH.P.K. me nr. 2025/0087, e datës 03/02/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje dhe pjesë elektronike të IT-së –Ritender 2 Pjesa2", me numër të prokurimit; 214-24-13444-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues – Policia e Kosovës.

2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, - Policia e Kosovës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje dhe pjesë elektronike të IT-së –Ritender 2 Pjesa2", me numër të prokurimit;214-24-13444-1-3-6.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Policia e Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 23.12.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me pajisje dhe pjesë elektronike të IT-së –Ritender 2 Pjesa2", me numër të prokurimit 214-24-13444-1-3-6.

AK me datën 15.01.2025 ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës ka shpërblyer "Inter Adria".

OE "Pattern" SH.P.K me datën 20.01.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. AK me datën 22.01.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 03.02.2025 operatori ekonomik "Pattern" SH.P.K SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0087 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me ketë, me 15.02.2025 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,
- Të mbetët në fuqi vendimi i AK-së

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE "Pattern" SH.P.K

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 1 Qëllimi për arsyen në vijim: Qëllimi i aktivitetit është marrja e furnizimeve plotësisht sipas kërkesave të AK dhe kriteret janë përcaktuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe si rrjedhojë AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me

fondet dhe/ose burimet e tilla. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji. Oferta e juaj është e pa përgjegjshme sepse nuk plotëson specifikat teknike te detyrueshme tek artikulli 22 dhe 23. Andaj, pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka shkelur Neni 7 Barazia në Trajtim/To- Diskriminimi. Pretendimet se AK ka shkelur nenin 7 te LPP-ës nuk qëndron pasi AK, sqaron se gjatë udhëheqjes se aktiviteteve te prokurimit, ku te gjithë OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit duke ju përfshirë edhe juve si ankues i ka trajtuar ne mënyrë te barabarte pa diskriminime dhe pa favorizime te asnjë OE, autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. sepse nuk plotëson specifikat teknike te detyrueshme tek artikulli 22 dhe 23. Pretendimi ankimor është i pa bazuar. Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Andaj AK i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë Operatoret Ekonomik bazuar në kërkesat teknike dhe profesionale te Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë. Gjatë udhëheqjes së këtij aktiviteteve të prokurimit, AK - Polica e Kosovës do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriteri të tillë, e dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës, FDT që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse dhe AK ka vepruar ne harmoni te plote me LPP- dhe RRUOPP- ne pretendimi ankimor është i pa bazuar. AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 59- Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara me njoftimin për kontratë, FDT dhe specifikimet teknike të detyrueshme Aneksi. Andaj AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e të gjithë ofertave në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Prandaj ky pretendim i OE është i pa bazuar. Pettern Shpk-.ne dosjen e tenderit tek specifikat teknike tek aneksi 1 është kërkuar. Ne kolonën e dytë të shënohet emri i plote i pajisjes (Lloji/Modeli me te cilën aplikohet) dhe po ashtu te bëhet përshkrimi i specifikave Obligative si dhe linku i produktit me te cilin ofertohet.

OE nuk plotëson specifikat teknike tek artikulli 22 dhe 23. Artikulli 22. Nga AK është kërkuar Laptop Backpack 17.3" kurse është ofertuar Laptop Backpack me specifika te cilat dalloje ne linkun e ofruar nga ana juaj:

- AK ka kërkuar Volume: min.30 max.40L. ndërsa ne link paraqitet Volume (litres) 16.5L

- AK ka kërkuar USB port: Integrated, easy chargin (poëer bank not included), ndërsa ne link nuk shënon e as nuk paraqitet fare kjo pjesë.

- AK ka kërkuar dimensionet: 47x35x22cm, ndërsa ne link paraqiten (32x14x47 cm)

- AK ka kërkuar Extended dimension: 47x35x26cm ndërsa ne link nuk paraqitet se Backpack është Extended (zgjatshme-zgjerueshme)

- AK ka kërkuar Outside: Expandable:Yes; Backpack straps; Ergonomic backpack straps; Category:SoftLuggage; Zippers: Lockable zippers with discreet brandname logo ndërsa ne link nuk paraqiten fare këto specifika;

Andaj specifikat teknike te deklaruara nga OE ne kolonën e dyte nuk përputhen me specifikat teknike te produktit te specifikuar ne link;

Artikulli 23:Nga AK është kërkuar Laptop Backpack 15.6" kurse është ofertuar Laptop Backpack 15.6 me-specifikate-cilat dallojnë nga linku i ofruar nga ana juaj:

- AK ka kërkuar Volume:min231, max.271 ndërsa ne linkun e ofruar nga ana juaj nuk paraqitet fare kapaciteti ne litra;

- AK ka kërkuar Weight max. 1.5kg ndërsa ne linkun e ofruar nga ana juaj nuk paraqitet fare pesha e produktit te ofertuar nga ana juaj;

- AK ka kërkuar Outside: Category; Soft Luggage; Zippers: Locable zippers with discret brandname logo: Carrying Handle: Carrying handle on top: Extemdal pocket: 1 front pocket &2 side pocket;

Ecpandable:Yes; Smart Sleeve: Yes, ndërsa ne linkun e paraqitur nga ana juaj nuk specifikohet asnjëra nga këto gjera përveç mbajtëses se çantës (Carrying handle on top) qe shihet ne foto;

- AK ka kërkuar Backpackt straps Ergonometric backpack straps; Bottle holder:Yes; Spectolite 3.0; ndërsa ne linkun e paraqitur nga ana juaj asnjëra nga këto nuk shënojnë përveç Bootle holder qe shihet ne foto;

- AK ka kërkuar dimensionet 42.5x30x15cm ndërsa ne link dimensionet janë: 33x47x22cm (ndryshojnë nga kërkesa e AK)

- AK ka kërkuar extended dimension: 42.5x30x23 cm ndërsa ne link nuk paraqitet fare qe backpack është extended.

Ju si OE nuk jeni eliminuar se nuk ju kanë hapur linku por jeni eliminuar pasi qe produktet e ofertuara nga ana juaj nuk i kane plotësuar specifikat teknike minimale te kërkuara nga AK, konkretisht artikujt 22 dhe 23 edhe pse i keni deklaruar specifikat teknike ne kolonën 2 (kolona mbi specifikat e produkteve te ofertuara) ato nuk janë përputhur me specifikat reale te produkteve te cilat janë verifikuar ne linqet e ofruara nga ju si OE si dhe ne internet.

Neni 60 -Kriteret për Dhënien e Kontratës-Pretendimet për shkelje te neni 60 të LPP-së, AK sqaron se nuk ka bërë shkeljen e këtyre neneve pasi që është zbatuar ne përpikeni të plotë ky nenë pasi qe është rekomanduar për kontrate oferta e përgjegjshme me çmimin me te ulet ndërsa oferta e Juaj është oferte e pa përgjegjshme sepse nuk plotëson specifikat teknike te detyrueshme tek artikulli 22 dhe 23.. Prandaj ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 1-se specifikat teknike te vendosura nga Autoriteti Kontraktues janë diskriminuese dhe favorizojnë një prodhues AK sqaron se nuk qëndron ky pretendim sepse AK ka kërkuar specifika sipas nevojave te AK dhe ky aktivitet i prokurimit ka qene i publikuar me shumë se një here po me specifika te njëjta dhe gjate fazës se tenderimit nuk ka pase asnjë pyetje ose kërkese për sqarim qe atakon specifikat teknike qe janë diskriminuese ose favorizues te një prodhuesi. Prandaj ky pretendim është i pa bazuar. Sepse nëse OE ka mendu se specifikat e vendosura nga AK janë diskriminues ose favorizues te një prodhues ka pas te drejtën te ankohet gjate fazës se tenderimit. AK gjate fazës se tenderimit nuk ka pranuar asnjë kërkesë për sqarim ose ankese rreth specifikat për këtë aktivitet. Prandaj ky pretendim është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 2-se te linkat e dorëzuar nga OE i rekomanduar nuk hapen tek artikulli 10 dhe 24 AK sqaron se nuk qëndron.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Pattern" SH.P.K në ankesën Nr. 0087/2025 janë parashtruar si në vijim:

Ne si Operatori Ekonomik "Pattern SH.P.K." shprehim pakënaqësinë dhe shqetësimet tona të thella ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues Policia e Kosovës për refuzimin e kërkesës sonë për rishqyrtim. Ky vendim ka karakter të padrejtë, tendencioz dhe përmban shkelje të parimeve të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), që garanton barazi, transparencë dhe trajtim të drejtë për të gjithë pjesëmarrësit. Veç kësaj ne, kemi ofruar një çmim më të ulët për këtë prokurim, konkretisht 464.00 euro ose në përqindje 10.5 % më të lirë se oferta e operatorit ekonomik të shpërblyer fitues, InterAdria L.L.C. Ky fakt tregon se vendimi dëmton buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi zgjedhja e ofertës më të lartë rrit kostot pa ndonjë përfitim të shtuar.

Më poshtë paraqesim argumentet tona, të bazuara në fakte dhe dispozitat e LPP-së. Pretendimi mbi kualifikimin teknik për pozicionet 22 dhe 23: Pozicioni 22: Linku i dorëzuar nga ne nuk ka qenë azhuruar për shkak të vonesave nga prodhuesi, por modeli i fundit i çantës plotëson të gjitha specifikat teknike të kërkuara. AK ka refuzuar të kërkojë pyetje sqaruese, duke mos ndjekur dispozitat e LPP-së. Pozicioni 23: AK pretendon që linku ynë nuk përmban kapacitetin në litra, por LPP-ja e obligon AK-në të na kontaktojë dhe të kërkojë sqarime para refuzimit.

Favorizimi i hapur i të shpallurit fitues Aktiviteti i prokurimit ka qenë objekt i ritenderimit dy herë, dhe në të gjitha rastet oferta jonë ka rezultuar më e lirë. Megjithatë, AK ka vazhduar të refuzojë ofertat tona pa bazë ligjore të qartë. AK ka favorizuar hapur kompaninë InterAdria L.L.C., gjë që vërehet nga mungesa e trajtimit të barabartë dhe standardet e dyfishta të aplikuara gjatë vlerësimit.

AK ka lejuar InterAdria L.L.C të ngarkojë linka për pozicionet 10 dhe 24 të cilat nuk hapen: Linqet e prezantuara nga OE fitues: pozicioni Pozicioni 24: https://blummanufaktur.com/epages/17894993.sf/de Nuk është e qartë se si AK ka vlerësuar këto pozicione të ofertës.

Nëse AK ka kërkuar pyetje sqaruese nga InterAdria L.L.C. për pozicionet 10 dhe 24, ne nuk kemi marrë asnjë dokument të tillë gjatë kërkesës për qasje në dokumente. Nëse kjo nuk ka ndodhur, lind pyetja se si AK ka vlerësuar këto pozicione.

Ky veprim reflekton një mungesë transparence dhe një mosrespektim të procedurave të parashikuara. AK nuk ka lëshuar letër standarde për Pattern SH.P.K., as si tenderues i suksesshëm, as si tenderues i eliminuar. Të dyja letrat i janë dërguar InterAdria L.L.C, duke krijuar kundërthënie dhe paqartësi. Kjo situatë ngrit pyetjen nëse InterAdria L.L.C është shpallur fitues apo eliminuar.

Specifikime teknike të paarsyeshme dhe të anshme: Specifikimet teknike të vendosura nga Autoriteti Kontraktues përmbajnë detaje të tepërta që anojnë drejt një prodhuesi specifik, duke kufizuar konkurrencën dhe favorizuar një ofertues të caktuar. Kërkesat e tilla jo-funksionale dhe të paarsyeshme janë në kundërshtim të parimeve të prokurimit publik

Kërkesat tona: Në bazë të Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, ne kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim dhe të merret parasysh oferta jonë, e cila është më e favorshme për buxhetin e Republikës së Kosovës dhe plotëson të gjitha kërkesat teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktues.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05/02/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0087/2025, i cili është dorëzuar me datë 15/02/2025.

Lidhur me pretendimet e OE "Pattern SH.P.K." eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0087 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1: OE "Pattern sh.p.k." shpk-Lipjan pretendon se AK. Policia e Kosovës nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 1 të LPP-së. Ekspertja thekson se ndër tjera qellim i këtij neni është ti udhëzoj autoritetet kontraktuese që të sigurojnë mënyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen, procedurat që do te ndiqen, te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, si dhe të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik. AK e ka trajtuar OE ankues si të eliminuar, me arsyen se linku i vendosur sipas kërkesës qe ishte ne faqen 16 te DT përkatësisht te sqarimi nen specifika teknike, pra linku i vendosur nga ofertuesi-ankuesi pajisjet qe na jepte ky link e qe nënkupton se me te njëjtat ka ofertuar OE ankues nuk i plotësonte specifikat teknike qe ishin paraparë me aneksin 1 te dosjes se tenderit, për mënyrën ma te detajuar do ta sqarojmë te pretendimi për shkeljen e nenit 59 te LPP qe ndërlidhet me këtë pretendim.

Ekspertja është e mendimit se nuk qëndron pretendimi i OE ankues sepse i njëjti ka dorëzuar linkun e qe nënkupton se ka ofertuar me pajisje qe nuk janë sikurse janë kërkuar me dosjen e tenderit. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2 dhe 3: OE “Pattern sh.p.k." shpk-Lipjan pretendon se AK Policia e Kosovës nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 7 dhe 59 të LPP-së. Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i nenit 7 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Ekspertja thekson se qellim i nenit 59 te LPP-së, është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të bëhet Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve, fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit, i cili pasi i ka vlerësuar ofertat e pranuara ka dhënë rekomandim dhe i njëjti rekomandim është aprovuar nga udhëheqësi i prokurimit. Ekspertja sqaron se Autoriteti Kontraktues me rastin vlerësimit të ofertave, operatorin ekonomik ankues e ka trajtuar si Operator Ekonomik të eliminuar ne harmoni me nenin 7 dhe 59 të LPP-së. OE ankues nderë të tjera pretendon se është eliminuar edhe pse ishte oferta ma e lirë dhe pretendimi mbi kualifikimin teknik për pozicionet 22 dhe 23, Pozicioni 22: Linku i dorëzuar nga ne nuk ka qenë azhuruar për shkak të vonesave nga prodhuesi, por modeli i fundit i çantës plotëson të gjitha specifikat teknike të kërkuara. AK ka refuzuar të kërkojë pyetje sqaruese, duke mos ndjekur dispozitat e LPP-së.

Pozicioni 23: AK pretendon që linku ynë nuk përmban kapacitetin në litra, por LPP-ja e obligon AK-në të na kontaktojë dhe të kërkojë sqarime para refuzimit. Ekspertja sqaron se e ka ekzaminuar linkun e vendosur nga OE ankues dhe sqaron se pajisjet qe na jep linku i vendosur nga OE ankues nuk janë në harmoni me specifikat e kërkuara nga AK për ta pasqyruar ne mënyrë me te detajuar ne kemi klikuar ne linkun e vendosur te pozicioni 22 te lista e çmimeve dhe linkun e vendosur te pozicioni 23 dhe aty hapen pajisjet dhe ato kur i krahasojmë me specifikat teknike te parapara ne aneksin 1 te DT apo edhe te Lista e çmimeve te pozicionet përkatëse vërtetohet se nuk janë ne harmoni me specifikat e parapara me DT për pozicion e theksuara ma lart.

AK me Raportin e vlerësimit, me Njoftimin mbi vendimi (B58) dhe me vendimin me te cilin është refuzuar kërkesa për rishqyrtim në mënyrë te detajuar ka sqarua se çka nuk ishte ne harmoni me pozicionin 22 dhe pozicionin 23 te ofertës së OE ankues, ekspertja sqaron se ka klikuar mbi këto linke dhe te njëjtat nuk na japin produkte siç janë kërkuar nga Autoriteti kontraktues. Sqarim ma i detajuar OE ankues nuk ka ndonjë pretendim konkret se i ka plotësuar këto specifika por nga pretendimi i tij shihet se thekson se linku i dorëzuar nga ne nuk qenë azhuruar për shkak te vonesave nga prodhuesi dhe thekson se ka ofertuar me çmim ma te lirë dhe precizon se nuk i ishte kërkuar sqarime shtesë dhe i njëjti pretendon se do duhej AK te kërkojë informata shtesë.

Ekspertja sqaron se kur OE oferton me specifika qe nuk janë në harmoni me dosjen e tenderit ,AK nuk është i obliguar të kërkojë informacion shtesë, jo vetëm se nuk është i obliguar por edhe nuk ka te drejtë te kërkojë informacion shtesë sepse këtë e sqaron në mënyrë decidive Udhëzues 002 2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për prokurimin Publik , neni 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve. 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së.

Sqarim: linku-linqet qe ka ofruar OE ankues për pozicionin 22 dhe 23 nuk na jep produktin siç ka kërkuar AK dhe kjo është shumë e qartë pa asnjë dilem ashtu siç e ka potencuar autoriteti kontraktues, pasi pajisja nuk i plotëson specifikat teknike ashtu siç janë kërkuar kemi te bëjmë

me një gjendje te detajuar te rregulluar me ligj përkatësisht me udhëzuesin e përmendur me lart te vendosur me ,prtSc'' dhe te cilin në mënyrë figurative e vendosa ma lart dhe i njëjti na sqaron se ne rastin konkret duhet te refuzohet tenderi pa kërkuar informacion te mëtejmë, pra Ekspertja sqaron se AK ka vepruar ne harmoni me legjislacionin primar dhe sekondar siç u sqarua ma lart.

E sa i përket pretendimit se linku i dorëzuar nga ne nuk ka qenë azhuruar për shkak te vonesave nga prodhuesi Ekspertja sqaron se kjo është obligim i ofertuesve e ne rastin konkret ishte obligim i OE ankues andaj AK ka pasur mundësi te kërkojë shtyrje te afatit gjate afatit te paraparë për sqarime e jo ne këtë fazë sepse kriteret e parapara me dosjen e tenderit janë obligim te respektohen nga te gjitha palët. OE ankues pretendon se AK e ka favorizua OE e shpallur fitues dhe pretendon se ka përdorë standarde te dyfishta ,sepse AK ka lejuar OE fitues te ngarkoj linka për pozicionin 10 dhe 24 te cilat nuk hapen. Ekspertja sqaron se OE ankues e ka bërë pretendim te pa qenë për te mos thënë in-ekzistent sepse fillimisht sqarojë se linket e dorëzuara për këto dy pozicione hapen dhe te njëjtat nuk janë kërkuar apo mundësuar te ri-dërgohen, por AK me date 08.01.2025 përmes letrës standarde ka kërkuar nga OE i shpallur fitues sqarime për pozicionin 24 për vendin e origjinës sepse vendi i origjinës shkruante „Blum Manufaktur/Europe'' dhe kërkesa ka qen qe te përcaktohet apo te dihet se nga cili shtet konkret do te furnizohet dhe ne te njëjtën ditë përmes platformës se e-prokurimit ka pranuar përgjigjeje nga OE se furnizimi do te behet nga Gjermania.

Pra nuk kemi te bëjmë medhënien e mundësisë se dërgimit te linkut apo linqeve siç pretendon OE ankues dhe nuk kemi te bëjmë me standarde te dyfishta sepse siç u sqarua nuk kemi te bëjmë me situate te njëjta siç ka pretenduar OE ankues. Andaj pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

OE ankues pretendon se AK nuk ka lëshuar letër standarde për Pattern SH.P.K., as si tenderues i suksesshëm, as si tenderues i eliminuar. Të dyja letrat i janë dërguar InterAdria L.L.C, duke krijuar kundërthënie dhe paqartësi. Kjo situatë ngrit pyetjen nëse InterAdria L.L.C është shpallur fitues apo eliminu. Ekspertja sqaron se pjesërisht qëndron pretendimi i OE ankues, sepse, te letra standard për tenderuesin e suksesshëm dhe te letra standard për tenderuesin e eliminuar shkruan: OE Inter Adria LLC, mirëpo ekspertja sqaron se te dyja këto letra standard hartohen bashkërisht me formularin B58 Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues, dhe në faqen e parë te këtij vendimi jepen te dhënat e ofertuesve dhe vlerat me te cilat kanë ofertuar, gjithashtu ne faqen e parë shkruan emri i OE te shpërblyer me kontratë, duke precizuar edhe vlerën, datën, dhe nënshkrimi apo emri i ZPP .,e nga kjo kuptohet se cili OE ishte fituesi dhe kuptohet se te letra standarde për tenderuesin e eliminuar ka mbetur gabim emri i OE., sepse nga ekzaminimi i lëndës në disa dokumente të tjera kuptohet se cili ishte fituesi dhe cili ishte ofertuesi i eliminuar, pra edhe pse kemi te bëjmë me një pretendim pjesërisht te bazuar ne do te rekomandojmë qe të mbetet ne fuqi vendimi i AK-së sepse edhe po te kthehej lënda ne rivlerësim ky pretendim nuk do te ndikonte ne ndryshimin e rezultatit sa i përket fituesit, andaj me qellim te ekonomicitetit dhe efikasitetetit te procedurës dhe pasi ky pretendim nuk ka efekt për ndryshimin e rezultatit sa i përket fituesit ne rekomandojmë qe te mbetet ne fuqi vendimi i AK-së.

Ekspertja sqaronse ky pretendim është pjesërisht i bazuar por meqë i njëjti nuk ka efekt juridik ne rezultatin përcaktimit-ndryshimit te fituesit trajtohet si devijim i vogël nga ana e AK dhe si pretendim ne përgjithësi për shkeljen e nenit 7 dhe nënti 59 te LPP-së trajtohet si i pa bazuar. Andaj, Ekspertja sqaron se ky pretendim është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr. 4: OE "Pattern sh.p.k." shpk pretendon se AK Policia e Kosovës nuk e ka respektuar qëllimin e nenin 60 të LPP-së. Ekspertja thekson se qellim i këtij neni është vendosja e kriteret për dhënie të kontratës, ku kriter ishte tenderi i përgjegjshëm me çmim më te ulët. OE ankues ndër te tjera pretendon se me rastin eliminimit te ofertës tonë AK ka shkelur nenin 60 te LPP-së sepse jemi eliminuar edhe pse ishim ofertues me çmim ma te lire. Ekspertja sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues pasi qe ky pretendim ndërlidhet edhe me pretendimet e tjera dhe pasi që të njëjtat ishin të pa bazuara, edhe ky pretendim nuk qëndron dhe është i pa bazuar sepse OE ankues ka ofertuar me çmim ma te lire, por nuk i ka plotësuar specifikat teknike te parapara me dosjen e tenderit. Andaj, Ekspertja konstaton se ky pretendim është i pa bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaq operatori ekonomik nuk është deklaruar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtuese i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE"Pattern" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues

mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE“Pattern” SH.P.K. janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pa bazuara. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik OE“Pattern” SH.P.K. duhet refuzohet si e pa e bazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, për aktivitetin e prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës, 15.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje dhe pjesë elektronike të IT-së –Ritender 2 Pjesa2”, me numër të prokurimit; 214-24-13444-1-3-6, inicuar nga autoriteti kontraktues – Policia e Kosovës

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0087, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar ”Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj” lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE“Pattern” SH.P.K. i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **Pattern SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: